



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,  
Kulturë, Rini e Sport  
Mbledhja nr. 14  
Prishtinë, më 21.10.2008 ora 10:30  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës  
Salla nr. N.10

**P R O C E S V E R B A L**

nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Fatmire Berisha, Memli Krasniqi, Adem Hajdaraj, Donika Kadaj-Bujupi, Hestet Cakolli, Mark Krasniqi dhe Dragan Dimiq

Munguan: Enis Kervan, me arsye dhe Vlora Çitaku.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

**Rend dite**

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i shkresës së Asociacionit të Institucioneve të Arsimit të Lartë;**
- 3. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë lidhur me Bartësit Privat të Arsimit të Lartë (BPAL) në Republikën e Kosovës.**

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

**Kryesuesi**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

**1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

**Kryesuesi**, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të datës 13.10.2008 pa vërejtje.

## **2.Shqyrtimi i shkresës së Asociacionit të Institucioneve të Arsimit të Lartë;**

**Kryesuesi** lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, tha se kërkesa e Asociacionit të Institucioneve të Arsimit të Lartë ka të bëjë me mbajtjen e një seance dëgjimore ku do të ftoheshin përfaqësuesit e këtij Asociacioni për të debatuar lidhur me çështjen e akreditimit të bartësve të arsimit të lartë.

Lidhur me këtë çështje u hap debati ku diskutuan anëtarët e Komisionit.

**Donika Kadaj Bujupi** tha se kjo çështje është dashur të debatohet më herët dhe lidhur me këtë do duhej të dëgjoheshin edhe palët apo përfaqësuesit e institucioneve të arsimit të lartë.

Sa i përket nivelit të arsimit të lartë, ajo vlerëson se niveli në përgjithësi është i ulët, kjo dëshkohet edhe me rastin e mbajtjes e testit të maturës.

Ajo konsideron se vendimi i Qeverisë është një vendim arbitrar dhe i ngutshëm i cili është marrë në pako i njëjtë për të gjithë bartësit e institucioneve të arsimit të lartë pa i dëgjuar palët e tjera.

**Mark Krasniqi** konsideron se mënyra e arsimit në Universitetet Private është më tepër profitabile dhe jo arsimore, ai përkrahë idenë e organizimit të një dëgjimi publik si dhe përkrahë cilësinë dhe kontrollën e institucioneve të arsimit të lartë.

**Adem Hajdaraj** mendon që duhet t'i ipet mundësia edhe bartësve të institucioneve të arsimit të lartë të japin mendimet e tyre, megjithëse këto çështje janë të njohura për ne si Komision.

Një pjesë e madhe e Universiteteve Private kanë karakter komercial dhe se shumica e ligjëruesve në këto Universitete janë pa tituj shkencorë.

Ai konsideron se vendimi i Qeverisë është i drejtë dhe se si i tillë nuk kërkon që këto institucione të mbyllen tërësisht. Vendimi i Qeverisë parasheh të kryhet procesi i akreditimit të dytë në Agjencionin Kosovar të Arsimit të Lartë në mënyrë që të sigurohet një cilësi dhe kualitet i arsimit të lartë.

**Heset Cakolli** konsideron se duhet mbajtur një seancë dëgjimore në mënyrë që të dëgjohen edhe palët e dëmtuara e më pas të merret një qëndrim i Komisionit. Ai pajtohet me Vendimin e Qeverisë rreth kësaj çështjeje dhe vlerëson se gjendja në arsimin e lartë nuk është e kënaqshme.

**Fatmire Berisha** konsideron se është e nevojshme të mbahet një seancë dëgjimore ku do të debatohet lidhur me shqetësimet e bartësve të institucioneve të arsimit të lartë si dhe me Vendimin e Qeverisë së Kosovës. Sipas kërkesës së Asociacionit duhet të rishikohet pika 5 e Vendimit të Qeverisë së Kosovës e cila konsiderohet si bazike.

**Drita Kadriu** tha se kërkesa e Asociacionit të Institucioneve të Arsimit të Lartë ka të bëjë me mbajtjen e një seance dëgjimore, dhe se kjo çështje tashmë është e njohur nga shumë takime të organizuara në tryeza të ndryshme dhe në media. I gjithë problemi ekziston në cilësinë e këtyre institucioneve, andaj konsideron që do duhej të mbahej një

dëgjim publik ku do të ftoheshin përfaqësuesit e këtij Asociacioni që të japin mendimet e tyre në mënyrë që Komisioni më pas të merr një qëndrim lidhur me këtë çështje.

**Memli Krasniqi** mendon se lidhur me këtë çështje është dashur të debatohet më herët, ngase procesi i akreditimit të këtyre Institucioneve tashmë ka filluar. Ai tha se nga shkresa e Asociacionit të Institucioneve të Arsimit të Lartë shihet se përfshihen bartësit e pesë Universiteteve Private, ndërsa janë gjithsejt 31 Universitete që kanë aplikuar për akreditim, dhe se lidhur me këtë do duhej të ftoheshin për dëgjim edhe Universitetet tjera të cilat kanë aplikuar në procesin e akreditimit.

Kryesuesi kërkoi që anëtarët e Komisionit të deklarohen lidhur me këtë kërkesë. Anëtarët e Komisionit vlerësuan se duhet ftuar vetëm përfaqësuesit e Asociacionit të Institucioneve të Arsimit të Lartë të cilët i janë drejtuar Komisionit lidhur me mbajtjen e seancës dëgjimore.

Komisioni pas debatimit të kësaj çështjeje mori këtë :

#### Vendim

Që të Organizohet dëgjim publik sipas kërkesës së Asociacionit të Institucioneve të Arsimit të Lartë lidhur me çështjen e akreditimit të bartësve të arsimit të lartë. Dëgjimi publik do të mbahet të hënën me datë 03.11.2008 nga ora 10,30 ku do të ftohen përfaqësuesit e Asociacionit të Institucioneve të Arsimit të Lartë.

### **3. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë lidhur me Bartësit Privat të Arsimit të Lartë(BPAL) në Republikën e Kosovës.**

Kryesuesi i Komisionit tha se lidhur me këtë pikë e rendit të ditës do të merret një qëndrim pas mbajtjes së dëgjimit publik lidhur me këtë çështje.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 11,20.

*Përgatitur nga*

Njësia për mbështetjen e Komisionit

**Kryesuesi i Komisionit,  
Agim Veliu**